



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI
ADRESA KAJO KARAFILI
TEL: 683030361

VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 8134

Tirane më 30/12/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024053240432054143

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER RIDVANA G. RUÇI



AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQATES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Stone 2020 AL”shpk

Në Tiranë, sot me datën 30/12/2024(dy mije e njetete e kater), u mbledh grupi themelues i shoqerise e quajtur “Stone 2020 AL”.

Skënder Dedja, atësia Allaman, amësia Hike, shtetas Shqiptar, lindur në Dukagjin, Mat dhe banues në TIRANË, lindur më 21/10/1961, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal G11021105W.

Visjan Dedja, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në TIRANË, lindur më 28/06/1989, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I90628068F.

Florian Dedja, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 28/04/1998, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal J80428053V.

Zaimir Çullhaj, atësia Najaz, amësia Jemine, shtetas Shqiptar, lindur në Gyor, Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 10/02/1979, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal H90210093V.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqiten dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Akt Themelimi dhe Statutin, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “e”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
RIDVANA G. RUÇI



AKT THEMELIMI
&
STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE



Neni 1

FORMIMI I SHOQËRISË

Formohet shoqëria e me përgjegjësi të kufizuar, me emrin

“Stone 2020 AL” shpk

Me ortake themelues:

Skënder Dedja, atësia Allaman, amësia Hike, shtetas Shqiptar, lindur në Dukagjin, Mat dhe banues në TIRANË, lindur më 21/10/1961, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. personal G11021105W.

Visjan Dedja, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në TIRANË, lindur më 28/06/1989, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. personal I90628068F.

Florian Dedja, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 28/04/1998, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. personal J80428053V.

Zaimir Çullhaj, atësia Najaz, amësia Jemine, shtetas Shqiptar, lindur në Gror, Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 10/02/1979, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. personal H90210093V.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria ka fituar personalitet juridik me regjistrimin e saj në Organet Kompetente në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “Stone 2020 AL” shpk është një shoqëri tregtare, e themeluar nga z. Skënder Dedja, z. Visjan Dedja, z. Florian Dedja dhe z. Zaimir Çullhaj, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë. Kontributet e ortakëve përbejnë kapitalin e regjistruar të pasurisë. Ortaket gëzojnë kuotat e tyre në shoqëri, në përparim me kontributet që kanë dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria do të ketë seline e saj në adresën e mëposhtme:

Rruga “Jordan Misja” Pallati Avi Rezidenc, numer 4, Tiranë.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çle dege dhe/ose zyra përfaqësimi kudo brenda Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Shfrytëzimi me makineri, pajisje të zonave të miratura me leje shfrytëzimi të gurorëve, minierave të kromit, bakrit, nikelit etj të parashikuar nga ligji në Republikën e Shqipërisë.
- Organizimi i kantierëve, shesh pushimeve, ku do të instalohen makineri, pajisje për të shfrytëzuar sipërfaqen e territorit, gurit për tu përdorur si gur, ose nëpërmjet inpiantit të vendosur në sheshin e



- kantierit, te prodhoje te gjitha nenproduketet qe dalin nga guri. Keto gure apo nenproduketet e gurit shoqeria do ti perdore per nevojat e veta ose per te tretet sipas ligjit .
- Hapjen e rrugëve brenda siperfaqes te percaktuara ne harten bashklidhur me qellim te shfrytezimit sa me mire te gurores duke respektuar kerkesat e ligjit te shprehura keto ne lejen e shfrytezimit te dhene nga institucioni perkates ne Shqiperi.
 - Te hape(zgjeroj) rruge (duke marre leje nga institucionet vendore dhe qendrore) me qellim qe mjetet e renda te kompanise te levizin lirshem hyrje-dalje ne territorin e gurores qe shfrytëzohet nga kompania jone.
 - Te vendose impiante te ndryshme per te perpunuar guret qe dalin nga gurorja, qofte brenda territorit te gurores qofte ne vende te tjera qe i intereson kompanise duke respektuar te gjitha kerkesat e ligjit per hapjen e tyre.
 - Te instaloj linja per prodhimin e betonit pasi shoqeria te pajisen me te gjitha lejet e nevojshme per instalime dhe prodhimin e betonit qe perdoren ne sektorin e ndertimit per nevojat e saj dhe per te tretet brenda territorit te Republikes se Shqiperise.
 - Te marre pjese per tendera rruges, tunelesh apo investime te tjera private ose publike brenda rregullave te konkurences, duke nenshkuar kontrata dhe marreveshje me qellim rritjen e financave te kompanise.
 - Te prodhoje blloqe guresh dekorativ ne qofte se ne territorin brenda kordinatave te miratuara do te dale ne thellesi te tokes gure dekorativ qe klasifikohet si material i nevojshem dhe me interes per shoqerine tone.
 - Te organizoje dhe te beje transport me mjete transporti brenda territorit te Republikes se Shqiperise, duke transportuar kryesisht guret, rene, granil, cakull mali, cakull te prodhuar nga linja e prodhimit te inerteve si dhe cdo nenprodukt tjeter qe shoqeria do te prodhoje ne guroren apo ne pikat qe do te ngrihen linja te perpunimit te gurit per prodhim inerteve. Shoqeria do te kete per objekt per te transportuar me mjete e saja ose duke kontaktuar te trete cdo material te lejuar nga ligji dhe qe i sjell te ardhura shoqerise tone.
 - Te instaloj linja prodhimi asfalti per nevoja te projekteve te kompanise tone si dhe per te tretet qe kan nevoj duke u pajisur paraprakisht me te gjitha lejet e nevojshme per prodhimin, transport, zbatim te projekteve te ndryshme te kontraktuara nga ne ose te kontraktuara nga shoqeria jone dhe te tretet
 - Rikonstrukcion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash.
 - Pastrim dhe gjelberim i hapsirave publike. Rehabilitim i objekteve pas shfrytezimit. Instalime elektrike dhe hidraulike.
 - Ndertim dhe mirmbajtje rruge dhe kanalizime. Material ndertimi, punime ndertimi, hoteleri, turizim.
 - Ngritja dhe mbulimi i kontruksioneve te kulmeve. Punime dhe sherbime te tjera te specializuara ne ndertim.
 - Suvatime dhe montime dyer, dritare, shkalle etj. si dhe kryerja e aktiviteteve te tjera te ngjashme me to.
 - Tregti pajisjesh te ndryshme, material ndertimi dhe mallrat e import-eksport me shumice dhe pakice, ushtrimin e aktivitetit te shfrytezimit minerar per mineralin gelqeror-dekorativ, per gurore, per te shfrytezuar burimet natyrore te tokes dhe te nentokes te burimeve natyrore, gjeometrike, hidroelektrike uxor dhe solar, si ne Shqiperi dhe jasht saj, perpunimi dhe tregtimi i burimeve natyrore qe vijne nga toka dhe nga nentoka, vete ose duke ju referuar te treteve.

Neni 5 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200 000 ALL (dyqind mije).

Kapitali themeltar I ndare si me poshte:

1. Ortaku z. Skënder Dedja me 40% (dyzet) te kuotave te kapitalit te shoqerise.
2. Ortaku z. Visjan Dedja me 25% (njezet e pese) te kuotave te kapitalit te shoqerise.
3. Ortaku z. Florian Dedja me 25 % (njezet e pese) te kuotave te kapitalit te shoqerise.
4. Ortaku z. Zamir Cullhaj me 10 % (dhjete) te kuotave te kapitalit te shoqerise.



Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejta e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 7 Organet e shoqerise

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga organet saj qe jane si me poshte:

1. Asambleja e ortakeve te shoqerise.
2. Administratori i shoqerise.

Mbledhja e ortakeve eshte organ vendimmarres i shoqerise.

Mbledhja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mbledhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mbledhet te paktën nje here ne vit.



V2024053240432054143

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te perckaktoj qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katërmbëdhjetë) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çështje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe perckaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Neni 8 Administrimi

Organi Administrues / Administratorët

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar.

Z. Skënder Dedja, shtetas shqiptar, i biri i Allaman, i datelindjes 21/10/1961, lindur ne Dukagjin, Mat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim nr. Personal G11021105W.

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

① administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;



V2024053240432054143

- (ii) perfaqesojë Shoqërinë;
 - (iii) kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
 - (iv) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - (v) krijon një sistem njoftimi të përshtatshëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - (vi) kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
 - (vii) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
 - (viii) kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
 - (ix) therran mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.
- Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për të vepruar në emri dhe për llogarinë e tij, duke specifikuar / përcaktuar kategoritë e akteve dhe veprimeve që përfaqësojnë mund të kryejë. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosën kufizime të kompetencave të administrimit.

Neni 9

Ortakët dhe punonjësit e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 10

Marredheniet e punës

Marredheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Te punësuarit duhet të përgjigjen për demot që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mospërfundimet e tyre sipas ligjit.

Neni 11

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të behen publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i kësaj shoqërie.



Neni 12

Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të paraqet një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 13

Marredheniet e punës

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt.31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e bilancit dhe rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventar. Pasi vërehen fondet si më sipër dhe paguhet detyrimet fiskale të ardhurat që mbeten ndahen midis ortakëve dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 14

Çdo mosmarreveshje që lind ndërmjet ortakëve mirkuptimi dhe bisedimet do të jenë mënyra me e preferuar e komunikimit mes anëtarëve. Por nëse nuk gjendet dakortësia atëherë çështja do të kalojë për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe çdo vendim i formës së prerë do të jetë i zbatueshëm nga palet.

Neni 15

Prishja e Shoqërisë

Shoqëria priset (i) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB; ose (iv) me vendim gjykatës; ose (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.



V2024053240432054143

Neni 16

Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 17

Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar. Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhen Shqipe.

Ortakët Themelues të Shoqatës "Stone 2020 AL".

z. Skënder Dedja

z. Florian Dedja

z. Visjan Dedja

z. Zaimir Cullhaj

ZAIMIR CULLHAJ

